



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve
Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Lënda: *Minutat e takimit nga diskutimi i projektligjit “Për Moratoriumin e Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.*

Ditën e hënë, datë **08.02.2016**, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për projektligjin **“Për Moratoriumin e Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”**.

Pjesëmarrësit në këtë dëgjese publike përfshinin kryesisht përfaqësues nga Federata dhe Shoqatat e ndryshme të gjuetarëve në vend, përfaqësues të disa shoqatave mjedisore të anagazhuara në mbrojtjen e biodiversitetit, staf akademik, ekspertë të pavarur mjedisorë, etj., si më poshtë:

Z. Mevlan Jaupaj, President i Shoqatës së Gjuetisë Turistike,
Z. Kujtim Hasani, Zv. President, Shoqata e Gjuetarëve,
Z. Enton Muho, Anëtar i Këshillit Kombëtar të Federatës së Gjuetarëve,
Z. Taulant Bino, AOS,
Z. Sajmir Hoxha, NOE,
Z. Ahmet Mehmeti, Klubi Ekologjik Elbasan,
Z. Klodian Aliu, ASPBN,
Z. Genci Kadilli, ASPBN,
Z. Gjok Bici, ASPBN,
Znj. Mikaela Mahilaj, ASPBN,
Z. Mirjan Topi, PPNEA,
Z. Bledi Hoxha, PPNEA
Z. Elkonis Buhaljoti, PPNEA,
Z. Sazan Guri, G&G group,
Z. Gëzim Peristeri, gjuetar,
Z. Hasan Jera, Shoqata e Gjuetarëve Shkodër,
Z. Robert Çibuku, subjekt i gjuetisë turistike,
Z. Them Perri, Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim,
Z. Bujar Hyka, Federata e Gjuetarëve dhe Peshkatarëve Sportivë “Kujtim Pano”,
Z. Fadil Malko, subjekt i gjuetisë turistike,
Z. Kastriot Koro, Pedagog, UBT.

Nga Ministria e Mjedisit morën pjesë këta përfaqësues:

Znj. Elvana Ramaj, Drejtorja e Biodiversitetit,

Z. Zamir Dedej, Drejtor i Përgjithshëm, AKZM,
Z. Ermal Halimi, Drejtorja e Biodiversitetit,
Z. Admir Seci, Drejtorja e Biodiversitetit,
Znj. Shpresa Harasani, Drejtorja e Biodiversitetit,
Znj. Edit Vardhami, Drejtorja e Biodiversitetit,
Znj. Enkelejda Malaj, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit,
Znj. Edlira Dersha, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit;

Takimi u hap nga **znj. Elvana Ramaj**, e cila nisi të prezantonte nismën e Ministrisë për zgjatjen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë edhe për 5 vite të tjera.

Z. Them Perri, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim, ndërhyri për të lexuar një Deklaratë të kësaj Federate për të shprehur mendimin e tyre kundër kësaj nisme, duke renditur si arsye kundërshtuese: dëmin ekonomik që i shkaktohej shtetit me anë të kësaj nisme, pasojat negative për gjuetarët, papunësinë e shtuar, etj.; të cilat sipas kësaj Federatë e bënë krejt të papranueshme këtë moratorium të ri të propozuar; dhe Federata, duke qenë kategorikisht kundër, nuk do të pranonte të vijonte më tej diskutimin me përfaqësuesit e Ministrisë dhe do t'i drejtohej Kuvendit dhe institucioneve të drejtësisë për të kundërshtuar kalimin e këtij projekt-ligji.

Pas leximit të deklaratës, z. Perri dhe një numër anëtarësh të kësaj federate lanë sallën.

Dëgjesa u vijua, me prezantimin që përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit bënë në lidhje me nismën e ministrisë për të vijuar Moratoriumin e Gjuetisë në të gjithë territorin e Shqipërisë edhe për 5 vjet të tjera. **Znj. Elvana Ramaj** parashtroi fakte dhe statistika që evidentojnë efektet pozitive që ka patur shpallja e Moratoriumit të Gjuetisë 2 vjet më parë dhe arsyet se përse megjithë përmirësimet e vërejtura, vijimi i kësaj mase është zgjidhja që ministria propozon edhe në kushtet aktuale.

Të dhënat që u paraqitën janë produkt i monitorimeve në terren, të mbledhura nga ekspertët e projektit IPA Natura 2000, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Sipas këtyre të dhënave dhe mendimeve të shumë ekspertëve të kësaj fushe në vend, Ministria e Mjedisit ka arritur në mendimin se pavarësisht efekteve të dukshme pozitive dhe rritjes së numrit të shpendëve, krahasuar me mesataren shumë-vjeçare, janë të shumta llojet e shpendëve që kanë nevojë për më shumë kohë për ripërtëritjen e nevojshme.

Gjithashtu Ministria bëri me dije edhe punën e zhvilluar nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e Moratoriumit, ku përmendim ushtrimin e mbi 650 inspektimeve për gjuetinë e paligjshme, vendosjen e 40 gjobave dhe sekuestrimin e 600 armëve të gjahut.

Fjalën e mori **z. Hasan Jera**, një përfaqësues i Shoqatës së Gjuetarëve në Shkodër, i cili u prezantua thjesht si një gjuetar. Në parashtrimin e tij, ai u shpreh se edhe për vendosjen e

Moratoriumit 2 vjeçar Ministria nuk mori parasysh mendimin e gjuetarëve, dhe tani duket se do të ndjekë të njëjtën rrugë. Ai u shpreh se nuk janë gjuetarët profesionistë ata që kanë dëmtuar faunën, por rreshtoi një sërë arsyesh, si ndryshimet klimatike, shtimi i numrit të armëve të gjuetisë që shiten pa kurrëfare kontrolli nga shteti, e që mbahen e përdoren pa leje, dhe shkatërrimi i pyjeve.

Ai foli për investime të humbura të mijëra gjuetarëve në vend, të cilat nëse miratohet Moratoriumi edhe për 5 vite të tjera, do të rriten. Më tej ai parashtrroi kërkesën e tij që Moratoriumi të jetë i pjesshëm dhe të lejojë gjuetinë e disa specieve, si shapka, rosa e egër, turtulli, etj.

Z. Zamir Dedej, u shpreh se zona e Shkodrës përbën një ndër zonat më problematike për gjuetinë e paligjshme në vend, megjithë punën e strukturave të AKZM-së për të gjobitur kundravajtësit dhe sekuestruar armët pa leje. Ai tha se AKZM po punon për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin me strukturat e Policisë së Shtetit, veçanërisht për të rregulluar dhe kontrolluar armët e gjahut. Ai gjithashtu u shpreh se edhe nisma tjetër e Ministrisë për Moratoriumin në Pyje do të ndihmojë jo vetëm për rigjallërimin e mëtejshëm të faunës, por edhe për evidentimin e kundravajtjeve.

Z. Dedej u shpreh se institucioni që ai drejton kishte pritur bashkëpunimin e gjuetarëve të ligjshëm për zbatimin e Moratoriumit dhe jo rreshtimin e tyre në krah të kundërt, pasi ata janë të parët që vërejnë nevojën për ripërtëritje të gjahut dhe nevojën për luftën kundër gjuetisë së paligjshme.

Z. Robert Çibuku u shpreh se Moratoriumi nuk ka dhënë rezultatet që priteshin, pasi për shkak edhe të kapaciteteve të ulëta, ministria nuk ka qenë e suksesshme në frenimin e kontrabandistëve. Ai kërkoi të dinte se përse ministria nuk kishte një vlerësim se sa kishte ndikuar Moratoriumi 2 vjeçar dhe përse Ministria në një kohë që mund të vijojë mbrojtjen e Zonave të Mbrojtura dhe të ndalojë gjuetinë brenda tyre, nuk mendon të hapë zona të lira për gjueti jashtë tyre.

Z. Çibuku i propozoi ministrisë që të punojë për eliminimin e gjuetisë natën, të vendosë limitet e gjuetisë dhe të mendojë për hapjen e kooperativave, siç bëhet në vendet e Bashkimit Europian, dhe jo thjesht të marrë masa ekstreme siç është zgjatja më tej e Moratoriumit.

Z. Zamir Dedej u shpreh se limitet e gjuetisë janë të vendosura, edhe se ligji e lejon krijimin e kooperativave, dhe se në fakt shoqatat e gjuetarëve fajësojnë Agjencitë Turistike dhe gjuetarët e huaj që janë shkaktarë të dëmëve të mëdha në faunën që gjuhet. Ai vijoi duke thënë se AKZM si një institucion i krijuar rishtazi po punon për rritjen e kapaciteteve të saj, për bashkëpunim më të ngushtë me Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera.

Z. Gëzim Peristeri u shpreh se gjuetarët duhet të kenë interes të drejtpërdrejtë për të mbrojtur faunën, por nga ana tjetër Ministria e Mjedisit duhet të marrë në konsideratë

edhe të tjerët dhe jo thjesht të propozojë masa ekstreme, por të punojë për të gjetur zgjidhje dhe rrugë të mesme.

Ai u shpreh se e kishte mbështetur Moratoriumin 2 vjeçar, pasi kishte menduar se kjo do të shërbente edhe si një kohë që institucionet të përgatiteshin për të kryer më mirë punën e tyre. Por ajo që, z. Peristeri kishte vërejtur ishte se edhe gjatë kohës që Moratoriumi ishte në fuqi institucionet përkatëse nuk kishin arritur të garantonin zbatimin e Moratoriumit në terren dhe se ai ishte dëshmitar i rasteve të gjuetisë të paligjshme. Ai propozoi që Moratoriumi të ishte i pjesshëm, dhe të mos përfshinte zonat kodrinore në afërsi të zonave të mbrojtura.

Nga ana tjetër ai u shpreh se Ministria e Mjedisit duhet të punonte me shumë me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë për të kontrolluar armët e gjahut, për regjistrimin e tyre, për vulosjen dhe bllokimin e tyre. Ai propozoi që Ministria të propozojë vendosjen e një takse për çdo armë të hapur gjahu, dhe në këtë mënyrë të mbledhë fonde për të ngritur kapacitetet e saj, pasi pa njerëz dhe financa Moratoriumi nuk mund të zbatohet dhe të ketë efektin e dëshiruar.

Z. Ahmet Mehmeti u shpreh se ky diskutim ishte i vlefshëm dhe se gjuetarët duhet të jenë të parët që ta mbrojnë natyrën dhe të bashkëpunojnë me institucionet për të luftuar gjuetinë e paligjshme, pasi në këto kushte vetëm masat ekstreme mund të çojnë në rehabilitimin e dëmit të madh të shkaktuar në vite, ndryshe s'do ketë asgjë as për të ruajtur e as për të gjuajtur. Ai u shpreh se pushteti vendor duhet të ketë përgjegjësi të qarta të vendosura në ligj për inventarizimin e faunës dhe gjahut dhe se në çdo rast është gjithmonë e domosdoshme që të gjitha palët të bëjnë kompromise.

Z. Sajmir Hoxha u shpreh se gjuetia e paligjshme përbën një problem, pasi është shtuar numri i personave që mbajnë armë gjahu. Legjislacioni është në përmirësim të vazhdueshëm, u shpreh ai, por problemi qëndron tek ata që abuzojnë me ligjin dhe në këto kushte kur problemi kryesor janë armët, bashkëpunimi më i ngushtë mes disa institucioneve për disiplinimin e armëve të gjahut është e vetmja zgjidhje. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme duhen vendosur sanksione më të mëdha për të gjithë ata persona që mbajnë armë dhe që pa leje gjuajnë. Masa të tjera duhen marrë, u shpreh ai, nga Ministrinë e tjera, nga Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Brendshme, si për kontrollin e armëve, për mbështetje financiare, logjistikë për strukturat ligjzbatuese, etj.

Ai u shpreh se është dëshmitar i ndikimeve pozitive të Moratoriumit 2 vjeçar në zonën e Divjakë-Karavastasë, edhe pse nga ana tjetër ka patur edhe tentativa për gjueti të paligjshme. Ai tha se kanë bërë një vlerësim për gjendjen dhe se mbështet Moratoriumin dhe shprehet i gatshëm për bashkëpunim edhe në të ardhmen me shoqata të tjera si PPNEA dhe INCA. Përsa i përket disa argumenteve që u shprehën nga parafolësit në lidhje me dëmin ekonomik që shkakton ndalimi i gjuetisë, ai u shpreh se kjo është e debatueshme, pasi në zonën e Divjakë-Karavastasë me shtimin e numrit të shpendëve ka patur një shtim

të interesit të turistëve për këtë zonë, ku numërohen rreth 300 turistë në muaj dhe kështu interesi i shtuar në eko-turizëm mund të sjellë të ardhura edhe më të mëdha.

Z. Mirjan Topi, PPNEA, u shpreh se dy vjet Moratorium nuk ishin të mjaftueshme, as për ripërtëritjen e faunës dhe as për institucionet për të rritur kapacitetet e tyre, megjithatë situata është në përsimërim. Ai u shpreh se për fat të keq Federata e Gjuetarëve nuk ka bashkëpunuar dhe se shoqata që ai përfaqëson është në mbështetje të vendimit për Moratoriumin, pasi nuk ka ardhur ende koha që të lejojmë gjuetinë.

Z. Taulant Bino, AOS, u shpreh se AOS kishte dorëzuar zyrtarisht mendimin pranë Ministrisë së Mjedisit, dhe se në fakt si ekspert ai kishte qënë mbështetës i idesë për Moratorium 4-vjeçar që para se të vendosej Moratoriumi 2-vjeçar, pasi ishte i mendimit se dy vjet ishin krejt të pamjaftueshme për të arritur rezultatet e nevojshme.

Ai u shpreh se sipas vlerësimeve të tyre nga viti 2004 – 2014 vriteshin mesatarisht 300,000 shpendë, kryesisht harabelorë dhe se për fat të keq gjuetia bëhej edhe brenda zonave të mbrojtura, për shkak të problemeve edhe të administratave të këtyre zonave.

Ai u shpreh se Moratoriumi ka dhënë efekte pozitive të vërejtura në disa zona, si në Divjakë-Karavasta, por edhe në Patok e Kune-Vain, ku vërehet një ngritje e pjesshme; efekte pozitive tek shkurta, thëllëza e vendit dhe në disa specie të tjera të vendit. Dhe, duke qënë se këto specie i gjen në të gjithë territorin, nëse duam t'i rimëkëmbim, nuk ka rrugë tjetër vetëm që Moratoriumi të shtrihet në të gjithë territorin dhe të vijojë më tej.

Nga ana tjetër, u shpreh ai, është e domosdoshme që Ministria të mbledhë të dhëna dhe të ardhura, si dhe të mos mjaftohet vetëm me shpalljen e Moratoriumit, por ta shoqërojë atë me një Plan Konkret Masash për zbatimin e tij.

Z. Klodian Aliu u shpreh se ka qënë pjesë e një projekti që është marrë me monitorimin e gjuetisë së paligjshme dhe se dëshiron të ndante disa nga gjetjet e këtij projekti, si më poshtë: nuk ekziston sistemi dhe mekanizmat planifikues për popullatat e specieve; strukturat janë të pamjaftueshme dhe të pamotivuara për të bërë punën e tyre, një inspektor është përgjegjës për 10.000 ha; është vërejtur edhe papërgjegjshmëri nga ana e strukturave për zbatimin e ligjit; nuk ekziston një mekanizëm kontrolli për restorantet që shërbejnë produkte të gjahut; Bashkitë duhet të ngarkohen me ligj me përgjegjësi të caktuara; duhet bërë vulosja e armëve; duhet punuar më shumë me komunitetin dhe ka ende raste të ulëta të procedimeve.

Z. Zamir Dedej u shpreh se strukturat e AKZM ende nuk kanë kompetenca për pezullim, por vetëm për konstatim të një shkeljeje. Dhe se AKZM është duke punuar për të marrë kompetenca që të mundësojnë ndërhyrje efikase.

Z. Elkonis Buhaljoti, PPNEA, sugjeroi se Ministria duhet të propozojë përfshirjen në Kodin Penal edhe të gjuetisë së paligjshme dhe se në nenin 6 të projektligjit edhe pse renditen një

sërë institucionesh si përgjegjëse për zbatimin e Moratoriumit nuk është e qartë si do të bëhet ndarja e përgjegjësive.

Znj. Elvana Ramaj u shpreh se mendohet se do të ngrihet një Task-Forcë pas miratimit të projektligjit dhe se ky do të jetë edhe momenti ndarjes së përgjegjësive përkatëse të gjithë institucioneve të përfshira.

Përgjithësisht diskutimi ishte i ndarë në dy grupime.

Grupimi i gjuetarëve u shpreh kategorikisht kundër një Moratoriumi të ri 5-vjeçar, të cilët paraqitën argumentat e tyre se përse kjo masë ekstreme i ndëshkonte ata dhe krijonte kosto për ta, për shtetin, përkeqësim të kushteve të tyre social-ekonomike, etj.

Grupimi tjetër, ai i përfaqësuesve të shoqatave mjedisore, u shpreh në mbështetje të Moratoriumit, por kërkoi që kjo nismë të shoqërohej nga Ministria e Mjedisit me një Plan Konkret Masash, që të garantonte zbatimin rigoroz në terren.

Dëgjesa u mbyll me falenderimet e rastit, duke ftuar pjesëmarrësit që të dërgojnë komente dhe sugjerime të tjera, brenda një jave.

Për çdo koment tjetër a sugjerim për përmbajtjen e projektaktit, lutem shkruani në adresën elektronike zyrtare të Ministrisë së Mjedisit që është info@moe.gov.al